



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURENCËS
KABINETI

NJOFTIM PËR SHTYP

Rasti: Rasti i përfutimit të kontrollit të shoqërisë Gruppo Servizi Associati S.p.A nga shoqëria Eurizon Capital SGR S.p.A.

Pranë Autoritetit të Konkurrencës është protokolluar shkresa nr.323 Prot., i AK, datë 05.07.2021 “Përqendrimi nëpërmjet përfutimit të kontrollit mbi Gruppo Servizi Associati S.p.A nga ana e Eurizon Capital SGR S.p.A. – Njoftim në përputhje me Ligjin për Mbrojtjen e Konkurrencës”, me të cilën jemi njoftuar në lidhje me transaksionin e përfutimit të kontrollit të shoqërisë Gruppo Servizi Associati S.p.A nga shoqëria Eurizon Capital SGR S.p.A.

Sipas “Kontratë Shitblerje Aksionesh” nënshkruar datë 30 qershor 2021, palët janë:

Blerësi: Pramerica SGR S.p.A, një shoqëri aksionare, me seli në Bergamo, Itali, e cila ofron konsulencë në aktivitetin e drejtimit dhe të bashkërendimit të Grupo Bancario Intesa Sanpaolo. Duke filluar nga data 1 korrik 2021, Pramerica SGR S.p.A është përthithur nga shoqëria Eurizon Capital SGR S.p.A.

Eurizon Capital SGR S.p.A është një shoqëri aksionare me një ortak të vetëm, me seli në Milano, e cila merret me investime, me tjetërsime dhe me negocime të të drejtave që kanë të bëjnë me titujt, merret me lëshimin dhe asgjësimin e çertifikatave të pjesëmarrjes etj. Eurizon Capital SGR S.p.A është shoqëri e Divizionit të Menaxhimit të Aseteve të Intesa SanPaolo Group dhe një filial i kontrolluar drejtpërdrejt nga Intesa Sanpaolo S.p.A.

Grupi Intesa Sanpaolo është i pranishëm në Shqipëri, nëpërmjet filialit të zotëruar tërësisht prej tij, Intesa Sanpaolo Bank Albania SHA, shoqëri aksionare e themeluar sipas legjislacionit Shqiptar, me objekt aktiviteti ofrimin e veprimtarive bankare, veprimtarive financiare dhe veprimtarinë e kasave të sigurimit.

Shitësi: Aurora Quattro S.p.A., shoqëri aksionare, e themeluar dhe ekzistuese sipas legjislacionit të Republikës së Italisë, me seli në Romë, me aktivitet kryesor: shoqëri me pjesëmarrje, aktivitete importi dhe eksporti, kontratë me rrjetin etj.

Target: Gruppo Servizi Associati S.p.A është një shoqëri aksionare, me seli në Romë, aktive në ofrimin e shërbimeve të menaxhimit të infrastrukturave dhe shërbimeve të sigurisë dhe

parandalimit të zjarrit për fusha të ndryshme në sektorin privat dhe publik. Gruppo Servizi Associati S.p.A zotërohet 100% nga Aurora Quattro S.p.A.

Gruppo Servizi Associati S.p.A. nuk është aktiv në Shqipëri.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit, rezulton se transaksioni i njoftuar është në përputhje me nenet 10 dhe 12 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar, sipas të cilit duhet respektivisht të realizohet ndryshimi i qëndrueshëm i kontrollit si dhe të plotësohen kriteret e xhiros.

Për sa më sipër, ky transaksion është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

Autoriteti fton palët e interesuara, që brenda pesë ditëve nga shpallja e njoftimit, të shprehin opinionet e tyre për transaksionin e njoftuar.

Opinionet mund të dërgohen pranë Autoritetit të Konkurrencës me fax (Nr. 0355 4 2234 497), me postë në adresën: Autoriteti i Konkurrencës, Rr. “Sami Frashëri”, Nr. 4, Kati IV Tiranë; apo me e-mail në adresën competition@caa.gov.al.